

# T'i udhëzosh fëmijët për shpëtim

Pasi të prezantohet Ungjilli, nëse njëri nga fëmijët (ose disa) shfaq interes në marrjen e një vendimi ftojeni në një ambient të qetë, pa shpërqëndrime, por që është i dukshëm nga të tjerët.

Të sigurohesh se fëmija është gati për shpëtim:

**Pyete: Mendoj që e di përse ke ardhur të flasësh me mua por, a mund të ma shprehësh me fjalët e tua?**

Përgjigjet mund të jenë të ndryshme, si: “Dua të shkoj në qiell”, “Kam mëkatuar,” “E dua Jezusin,” ose “Nuk e di.” Nëse fëmija thotë: “Nuk e di,” inkurajohet të kthehet te pjesa tjetër e nxënësve dhe mund të flisni më vonë.

Të dallosh nëse fëmija e ka kuptuar Ungjillin:

**Pyet: A mund të më tregosh ndonjë gjë për Librin pa Fjalë?**

Lejoje fëmijët të të shpjegojë Ungjillin. Mos prit përsosmëri. Pritshmëria është që të ketë kuptuar mëkatën dhe nevojën për faljen e Jezusit.

Lejoje fëmijën ta personalizojë nevojën për një Shpëtimtar:

**Pyet: A ke mëkatuar? Si ke mëkatuar?**

Tregoji **Romakëve 3:23** në Biblën tënde.

Nëse fëmija e mohon se ka mëkat në jetën e tij/saj, nuk është gati ta vazhdojë më tutje diskutimin. Nëse fëmija mund të të flasë për mëkatën e tij/saj dhe ta kuptojë mëkatën në mënyrë personale, mund të vazhdosh bisedën.

**Pyete: Kush është Personi i vetëm që mund të të falë e të të shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit?**

Përgjigjja: Jezusi.

**Pyete: Përse Jezusi?**

Përgjigjja: Sepse Jezusi është i përsosur, vetëm Ai mund të merrte ndëshkimin për mëkatën duke vdekur në kryq.

Tregoji **Hebrenjve 9:22b**.

Pastaj, fëmija mund të vendosë emrin e vet te fjalia: “Jezusi vdiq për mëkatet e \_\_\_\_\_.”

**Pyete: Çfarë ndodhi pasi Jezusi vdiq për ty?**

Përgjigjja: Ai u ringjall, që do të thotë se Ai fitoi mbi mëkatën dhe është i gjallë sot! **(1 e Korintasve 15:3b-4)**

# T'i udhëzosh fëmijët për shpëtim

Pasi të prezantohet Ungjilli, nëse njëri nga fëmijët (ose disa) shfaq interes në marrjen e një vendimi ftojeni në një ambient të qetë, pa shpërqëndrime, por që është i dukshëm nga të tjerët.

Të sigurohesh se fëmija është gati për shpëtim:

**Pyete: Mendoj që e di përse ke ardhur të flasësh me mua por, a mund të ma shprehësh me fjalët e tua?**

Përgjigjet mund të jenë të ndryshme, si: “Dua të shkoj në qiell”, “Kam mëkatuar,” “E dua Jezusin,” ose “Nuk e di.” Nëse fëmija thotë: “Nuk e di,” inkurajohet të kthehet te pjesa tjetër e nxënësve dhe mund të flisni më vonë.

Të dallosh nëse fëmija e ka kuptuar Ungjillin:

**Pyet: A mund të më tregosh ndonjë gjë për Librin pa Fjalë?**

Lejoje fëmijët të të shpjegojë Ungjillin. Mos prit përsosmëri. Pritshmëria është që të ketë kuptuar mëkatën dhe nevojën për faljen e Jezusit.

Lejoje fëmijën ta personalizojë nevojën për një Shpëtimtar:

**Pyet: A ke mëkatuar? Si ke mëkatuar?**

Tregoji **Romakëve 3:23** në Biblën tënde.

Nëse fëmija e mohon se ka mëkat në jetën e tij/saj, nuk është gati ta vazhdojë më tutje diskutimin. Nëse fëmija mund të të flasë për mëkatën e tij/saj dhe ta kuptojë mëkatën në mënyrë personale, mund të vazhdosh bisedën.

**Pyete: Kush është Personi i vetëm që mund të të falë e të të shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit?**

Përgjigjja: Jezusi.

**Pyete: Përse Jezusi?**

Përgjigjja: Sepse Jezusi është i përsosur, vetëm Ai mund të merrte ndëshkimin për mëkatën duke vdekur në kryq.

Tregoji **Hebrenjve 9:22b**.

Pastaj, fëmija mund të vendosë emrin e vet te fjalia: “Jezusi vdiq për mëkatet e \_\_\_\_\_.”

**Pyete: Çfarë ndodhi pasi Jezusi vdiq për ty?**

Përgjigjja: Ai u ringjall, që do të thotë se Ai fitoi mbi mëkatën dhe është i gjallë sot! **(1 e Korintasve 15:3b-4)**

Të bësh një zgjedhje personale:

**Pyete: Çfarë do të doje që Jezusi të bënte për ty?**

Përgjigjja mund të jetë e ndryshme: “Të heqë mëkatin tim,” ose “Të marrë ndëshkimin për mëkatin tim.”

**Thuaji:** Tek **Veprat 16:31** thuhet që, nëse besojmë në Zotin, Jezu Krisht (drejtoju faqes në ngjyrë të kuqe) mund të shpëtosh (faqja e zezë dhe ajo e bardhë).

**Pyete: A do të doje të luteshe dhe t’ia kërkoje Jezusit këtë?**

Nëse thotë: “Jo,” thuaji të vazhdojë të mendojë për këtë gjë gjatë javës dhe të flasë me ty javën tjetër, nëse do të dëshirojë.

Nëse thotë: “Po,” thuaji: “Përse nuk lutesh dhe t’i thuash Jezusit që ke mëkatuar, që beson në Të dhe se ke nevojë që Ai të të falë mëkatet dhe të të shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit.”

Lejoje fëmijën të lutet. Nëse ka nevojë për ndihmë me fjalët, tregoji se do ta ndihmosh, por duhet të kujtojë se po flet me Perëndinë dhe atë që thotë, duhet ta thotë nga zemra.

Siguria e shpëtimit:

**Pas lutjes, pyete: Çfarë bëri Jezusi për ty?**

Lejoje fëmijën të përgjigjet: Përgjigjja e tij/saj duhet të tregojë se e ka kuptuar që Jezusi e ka shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit.

**Pyete: Si e di ti këtë?**

Përgjigjja: “Bibla më thotë kështu.”

**Thuaji: Hebrejve 13:5b** na mëson se kur i kërkojmë Jezusit të bëhet pjesë e jetës sonë, Ai nuk do të na braktisë kurrë. Kërkoji të vendosë emrin e tij në fjalinë: “Jezusi nuk do ta braktisë kurrë \_\_\_\_\_.” Tashmë je pjesë e familjes së përjetshme të Perëndisë.

Thuajse se je i gëzuar për vendimin që ai/ajo ka marrë sot. Inkurajoje t’i tregojë dikujt tjetër për këtë vendim.

*Përshtatur nga trajnimi për shpëtim i CEF.*

Të bësh një zgjedhje personale:

**Pyete: Çfarë do të doje që Jezusi të bënte për ty?**

Përgjigjja mund të jetë e ndryshme: “Të heqë mëkatin tim,” ose “Të marrë ndëshkimin për mëkatin tim.”

**Thuaji:** Tek **Veprat 16:31** thuhet që, nëse besojmë në Zotin, Jezu Krisht (drejtoju faqes në ngjyrë të kuqe) mund të shpëtosh (faqja e zezë dhe ajo e bardhë).

**Pyete: A do të doje të luteshe dhe t’ia kërkoje Jezusit këtë?**

Nëse thotë: “Jo,” thuaji të vazhdojë të mendojë për këtë gjë gjatë javës dhe të flasë me ty javën tjetër, nëse do të dëshirojë.

Nëse thotë: “Po,” thuaji: “Përse nuk lutesh dhe t’i thuash Jezusit që ke mëkatuar, që beson në Të dhe se ke nevojë që Ai të të falë mëkatet dhe të të shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit.”

Lejoje fëmijën të lutet. Nëse ka nevojë për ndihmë me fjalët, tregoji se do ta ndihmosh, por duhet të kujtojë se po flet me Perëndinë dhe atë që thotë, duhet ta thotë nga zemra.

Siguria e shpëtimit:

05/2026

**Pas lutjes, pyete: Çfarë bëri Jezusi për ty?**

Lejoje fëmijën të përgjigjet: Përgjigjja e tij/saj duhet të tregojë se e ka kuptuar që Jezusi e ka shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit.

**Pyete: Si e di ti këtë?**

Përgjigjja: “Bibla më thotë kështu.”

**Thuaji: Hebrejve 13:5b** na mëson se kur i kërkojmë Jezusit të bëhet pjesë e jetës sonë, Ai nuk do të na braktisë kurrë. Kërkoji të vendosë emrin e tij në fjalinë: “Jezusi nuk do ta braktisë kurrë \_\_\_\_\_.” Tashmë je pjesë e familjes së përjetshme të Perëndisë.

Thuajse se je i gëzuar për vendimin që ai/ajo ka marrë sot. Inkurajoje t’i tregojë dikujt tjetër për këtë vendim.

*Përshtatur nga trajnimi për shpëtim i CEF.*